

NANDO ELMO

ATA NDJEZOT



KALUQI

NANDO ELMO

ATA NDJEZOT



KALUQI

*Sors immanis
et innanis
rota volubilis
(Carmina Burana)*

Publicato in proprio
Giugno 2024
Rivarolo Canavese
In copertina un disegno dell'autore

SI PARATHËNIË

*Më dorë tij, nana Mari'e Aronvet,
ndersa më vënje më gjumë
i ngjatur ket prëfri ytë
ture me rrëfjetur ato pralla
me korbin, pulat, gjelin, dhelprin
lepurin, kukuvinë, qenin e ulkun
më mëkonje fjalë arbreshe të moçme
të njëj tjetri shekul
çë sot mosnjeri nje më.*

*E më këndonje me zë t'ultë
“petkat e të mirat tona na i lam te Korona”*

*Ku ish Korona, na’?
xura pra se ish ka vin’ ajo gjufë
çë më mëkonej qisha
me të cilin akoma sod fjas,
si thot Shën Pali,
drejt me tën Zon*

*Fjalë, jo më gjë se fjalë
çë me lindjin ëndre edhe të keqë
prapa të cilevet bired gjithë gjella jonë*

1

Cje Mari'e Patituçit

Ndë pikë të ditës
përposh avullit të të trashit diell të gushtit
hipeshe në kundradritë
si një fandasëm ndër të veshurat tote të zeza

E zezë sa zbardhnej botëgjina
hipeshe ka shkëmbi
lul'e thatë ndë mes të të gjelbrit të shkuar
cje Mari'e Patituçit
me shkarpa e ngrakuar
e me gobaçe
e me katërzetë e dhjetë vjeç,
të drejtë o sikur, më krahë
ishe mund t'jet më e bukura
ndër të krishterët
ty e firasura si kështënjë

një grusht macàkaresh
te ku një meride e Shpirtit të Shënjët
kish bën folen

Të kujtonj cje Mari'
më e vogël se barri që kish ngrah
ishe edhe ti
ket pasqir'i thavmasisë
tempulli më i madh
i Hyinisë

Zoti Viçenx Matrangolo prift

T'ëndrra akoma, moj zoti Viçe',
 si t'ëndrrinj shpesh çë kur ike ka bota
 tyj çë na vënje dorën ndër krye
 e na dërgonje më paqë me Tënë Zonë

Parkalesnje për të mirët e për të ligjët
 mbal të cilvet kish rar i njëjti shi
 kish zbardhur e njëjta borë
 e i njëti diell kish shkilqier
 si shkilqen gjithaparë lavdi e Tënë Zoti

Sonde zbardhin e pjotë hëna
 e Pashkvet
 është e prëmta e shënjëtë
 e u përgjunjaz
 pres dorën tënde ndër krye
 jam i mëkatruam e shumë lotësh
 dëtor

po eam akoma m'ënder
e rrefiem si përshkohet shkretëria
e thuam pse ata ç'e përshkojin s'do të shohëjin
dheun e taksur
e pse ata ç'e kërkojin
s'do t'e përpyekjin Atin

e pres akoma të më djovasish
si një këndim pa fund
ματαιότητας ματαιοτήτων
pse këtë me mësove mirë
sa e kotë esht kjo gjelle
çë nga ngau edhe në dëtyrë

Lal Nxellmi furiz

Si ike ti e vajte ket ai llok ka mosnjeri më priret
 ashtu van djersët e tua e të tim ati
 rrëkimet e tua kur pirnje ndopat shatur
 gëzimet kur lagënje gojen me qelqin verë
 e ternje ballët tue marr frymë ka lodhësia e madhë

Na u pruar gjithësej kundër
 si prirej gadhjuri e të zëj me shkelbe

Van hjersa Masavetrat
 jan e i nxierjin frymë ullinjvet ferrat
 shqeptim udhritë çë bëgatjin Farnitat
 u stistin shpi ka Pandanat
 ng'u qelltin më skarecet Shimremal
 stala më nëng gjegji braminë e qevet

Ka Gallatra ng'u mbjodhë më një kshtënjë
shterpuan butet ku mbjonje garrafunet
për të korrat që drejtonej Viçenx'i Vulkanit

Kush e di ndose i pikset më gjiza
ndër kakavat lal Xhamatistës të Nginit
kush e di ndose akoma shërben djathe Mullaqi
ku vat ju mbatan revet
ktej u shuajtin zjarret përposh kusivet
që nëng mbjofen më me të mjelurit qumësht

Ti ike si ikin nga gjë

Na pse ngë kishim më që të bëjim
lam kufinjet e atdheut
e të ëmblat dhera e petkat e të mirat tona
që kishe ruajtur sa mos t'na i mir guça
kur frynej vorea e ligë
e gurgulisjin shirat ndër kanalletat.

Leonzio Capparelli jatrua

E u fjë, fjë, fjë
e më tandojin ëndrat
nani që jam edhe u te kufiri i gjelles
e shoh mbatan
anamesa atyrve ndjezot
figurën e stris'ate akoma e sjellur

Pse jan e më ngjaten vitrat
më se ata që gjelloi stria jote?
sa të të gjykonj?
Llargu qëft jatro'

Ishe jatroi
u një student i turpëshëm
rrinja përpara stris'ate pa folur

si mungar i ler
e njëherë çë kishe kapirtur problemin
“Vet kurmin mund të të shëronj”
më the me hjenë çë të kundërndanej.

E dinja se dinja shërbise pa vlerë
ishin jasht ka bota shërbiset time çë dinja
po dinja se do të kisha ikur
pa çë do të kisha perfunduar ditë pa vlerë

Kish dashur një jatrua çë shëronej angëthet:
“ Shi’ se edhe u do’ të kisha një jatrua,
kam edhe u – ture qeshur më the - te njejten sëmundje”

Shtove me një urtësi të moçme
se “nga një gjellon i vetëm përposh diellit”

Mbetëtim pa fjale e ng’u foltim më
e shkoj anamesa neve një qetësi
çë qe një jatri e tharët çë akoma qell’ me mua

Pra ike i ndëndur vitrash,
Dhon Leo', e vetim më le
mbi zëmërin e botës
e m'u ndodhëtin vjeç me të shumë se strisë sate
sa t'ja rrënj më të njëjtën rrodhi
dersë së made
mbatan së cilës ngë kan jatri

Cje Ruzarja-e Llupietrit

Ket syt e tu të verbër
mbi një buzqeshje
kujit i bënej hje një pan i kuq
i vënja re përfundimit pa fund
i njersisë sate.

Ku venje me paditurinë tënde?
Shkove gjellen pa urtësinë tonë
çë na bën të farmakosura ditët

“Një qelq verë”, zonja Mari’
i thonje mëmës sime
e zdripshe ka Kunsjuna
më hapin tëndë të lezë
me ngrah ato stolitë të rënda
të moçme çë dijin edhe më verë
të kamnojit të vatrës

Zdripu e lezë, cje Ruza',
ka Bregu
ku më pe se lindësja,
mësom se akoma ng'e xura
së gjellës cila është menxura

Një qelq verë, një qelq verë
sa të harrohem,
këtë e xura

Llillina e Llupietrit

Pra u qete
 nëng pikse më kangjele
 jo kënga ironike kundër zotravet e zonjavet të katundit
 vajte për poesië litire
 ç'i ditonje njëj më analfabet se ti
 e të diljin jo më lozje fjalësh arbëreshe
 po vajtime për jetën e shkrete

Pse bir - më thonje – më lipin fjalë
 një herë të mira të shajin veset e të gjallëvet
 sot mund të shkruanj vet për të vdekurit
 me një gjufë të vdekur
 çë kërkova ket gjufa litire

Kishe gjufë, kishe fuqi
 pra pjake bore gjufin e sat'ëme
 pra pjakë xure të shkruanje fjalin liti'

Po një herë e çuditshme ishe Lilli'
e huajë me gazet e tu
më skandalet që venje ture thënë
ture bën kriq
sa Ynë Zot mbjatu do të të kish lipisi

Maria Delfina Rossano

Kur e vogël doj' të dilnje
e xathur e e xheshur
si dilëjin ka katoqet
si maçe të esura
të bilët e sherbëtorvet e tët eti
ishe e shajtur ka gjithë gjitonia

Pra e madhe t'erdhe e të ngau urtësia
hyjnore kur zgjodhe t'ishe e vapëht si të vapëht
çë njohe te bota jasht ka shpia e bëgatë
me kashune pjotë grurë
bute me verë me xharra pjotë valë
kusië çë zëjin valë sipër zjarrit të math

Dëshirove vet bukën e shpirtit
u ultësove ture vatur mb'jornatë

te dherat e sherbëtorvet e tët eti
e të dogji vet eti e vërtetës
së cilës ng'j'arrëmi kurrë

E vertetja çë bën' e venje e lezë
si e lezë të qe sprënxa çë ngë ka kufir

Ngrenje grushtin te famila fashiste
ket lavderofshin idolat e të shkuamjes
e bëjin edhe Krishtin një hyjni idolatre

e veshnje fytyren e Guevara
e shpresonje te e ardhmja,
ikonë e re të Perëndisë
e nomotisnje “Capitini”, “Dolci”, “Bonaiuti”
ëmëre çë Firmozë mosnjeri njih
e përseritje vjershe të Ferdinando Tartaglia

“Bë atë çë mundin
atë çë ngë mundin lute

pa pritur prit

e ndërkaq këndo”.

E këndonje: ”Bandiera rossa”

Nani ç’u lirove ka kurmi

ka efimeri mish

thuam, Delfi’, ti motra e vogël e Krishtit

te cili parrajsë je pushon

e veshur mund t’jet me fjamurin e kuqë

ndersa na biremi te gjella jonë

ture mbetur qëndakra te zakonet tanë të rremë

pse thonje se Krishti është ngamon ó ἐρχόμενος

jo Ai çë mejtomi se erdhë

Ai çë ngamon vjen e gjykon të shkuarat

një gabim i math

E këndonje te një gjufë e moçme

ἀνάστα ó Θεός

κρίνον τήν γήν

*Tabanla, për ngllikëzin e Ungirn jotve**t*

Desha

vërteta desha kushdo erdh'e trokisi te dera ime

e e vetme ngë fjënja fare një natë

u e gjithve gjitona

Ndër mbrëmanet e mia desha të bëgatin

e sherbëtort e skarazevet

me një përfaqim të thellë,

me një dhelkë të hollë ëmësore

drejtë si dojin pa e ditur

burrat e mi

Sa ka njeriu etë

sa u ka ëmbëlsije,

mallëngjimi,

çë mosnjë ja dhuron,

e vin' e lidhëshin me mua
pa dijtur pse

Dashurova nganjë

Ka u mosnjeri vin' e bëj markatin
se ket u Ynë Zot kish bekuar mëkatin

Nani për një gjykim ju vinj përpara
për se sa desha
u çë ket Rregjëria do t'jem e para

Cesare Elmo im vëlla

Të kujtonj kur anamesa fagjevet e Shimremalit
 më thonje: “xheshu
 bëju i njom si gulia e skallierit
 kur i nxier fjetat e gjëmbura,
 le ajrin të të fasqonj kurmin pse ai është pronari”

E venje i xathur ture shtipur baret e sheshit

E:” përshtip – thonje – këtë bar të thart
 shi’ sa t’ëmbël grikin të lë”

Një galininë pra m’ofronje
 me lënget e dheut
 ka zjarr’i diellit të llonarit e pjekur
 me ujët e mjergulis s’haraksis e freshkuar
 ket ajret pakufirë
 e Shën Mërisë së Malit

Përgjunjëshe përpara diellit që perëndonej
i paqme me lotë ndër sy gjithësejen lavderonje
“Mos thuaj - më thonje - të liga kundër mosgjë
e mosnjeri /
gjithësej ë i bekuar”

Ku je Çesari' nani që bore
edhe stolinë e rëndë të kurmit
nani ç'je hi i shprishur ndër këto brinja?
Thuam ndose të harepsin qielli i kalthër
ndose luan lart e posht ket ajri i lirë
ndose rrugullisen atoment e tu ndër llavinat
ndose të ngrohën bota
kur lefet hëna e ligë ka livandi
e ndër çukat bie bora

U bëre gjeniu i llokut
ku hipshe sa dakord të vëhshe
me gjellën që ngë të qe e tërë e lezë
po ishe i lezë ti ç'i luanje ndër sheshet
një valle hyjinore

Maria De Marco mëma ime

Ndose do t'ishin dhëmbjet vet ata të lindjes
 do t'ishin i njëj çasti që qitas harrofen
 po anghi ç'i vjen prapa
 që rron sa gjella jonë
 ngë kam si t'e thom
 pse qeva bir i bjerrë
 pa krye
 mò i huaji ndër njerzët që banojin te shpia jote

E di, mëmë, si ati ç' jam,
 se harramja mbulon gjithësej
 po anghi rron i fshefur
 e pikulon lotë të heshtura
 si saraqë që të ha jo vetëm misht

E kështu vete gjella jone
ture i lindur nga dita bilët
ket dhëmbja pa kufir
njera kur harakset dita
kur bie e vdekjes një kumborë

Xura se nga mëmë, më se etrat pa kujdes,
ndose gjella ë kryqe.,
do kënduar nga moment
Stabat mater lacrimosa
juxta crucem dolorosa

Fernando Manes profesor

“*Animus*” e “*Anima*”

thoj dhon Fernandi Manes

mjestri i gjithë atyrve që gjë dijin Ungir

“*Animus*” e “*Anima*”

thoj: Ngë kemi fjalë sa t’i pirkthemi arbërisht

e jemi të dyshëm drejt si thonej Aristofáni

e kush ka më “*Animus*” është më i egër

i trash ket shpirti

kush ka më “*Anima*” është më i holle, më i sjellur

Ti mbaju ket mes

e bë një

E po që je burr

mos harro të levroshin anën tënde femërore

gjithëgjithë ndose do t’jesht artist

mba mendë se muzat ngë duan t’jen parë

venë të fashquara me mjergulla
e këndojin natën
ture u fshefur
ket rrugat t'errura
e më të mënjanuara
si hereherë
Firmozë natën ven më një arganet
të dejimit të mallinguar ka ndonjë dashuri e bjerrë
e ngë din ka ven
ven
ven pa kufir ture lajtur

Mos u bë artist pasqir'i gjelles këtje jashtë
le të të lulzonj ket gjiri
ajo muzik'e hollë çë këndon të çuditshme ëndra
e vë re mos për atë çule t'jesh i shajtur
ka shumiza çë do gjithësej të lajtur

Francesco Damis gjyqtar

Ish erë aso mbrëma

“Gjegje” thoj avukat Damësi
 që kish ardhur të mirrë frymë ka Pëllaci Firmozë
 ture lënë te Ferma e vapur ajiret të sëmure e gushtit
 “gjegjë e mirrë vesh, si ullurisjin
 ndër kështënjat e fagjet e malit
 ki është Shpirti që na thërret
 sa të hipemi e të vemi mbatan më sjet të gjithëseis
 përtej revet që fshehjin kaltrinë e qiellit

Jan mejtimet që na tërbullojin paqen e mendjes
 na hipen ka mbrëndja
 si hipet ajri i bën i rënd
 ka e vathëvet koprea

Bënej diskurse shpirtërorë
avukati, pitagorik i zgjedhur,
ndersa na ofronej
pemet e kopshtit
e bukën e verën e dheravet e t' jatit:
“hami e pimi
na gëzon dheu
me dhuratat e tij
njera kur mos të na pastë
të mbuluar te sjet'i tij
ahirna do shpirti të priret ajër ket ajri
si priret uji ka deti
e zjarri çë na ndan ndër atomet tanë

Empedokli thoj se nganjë do priret ka erdhë
bota ka bota uji ka ujët zjarri ka zjarri
e Shpirti i levratur ka kalhtri'e qiellit

Zo e dhoksë past
-thoj avukati-

kush ka besë se fare gjë mbaron
e neve na nget e përjetshmja jetë
ndomos se pasprënza na çivon
e ditët tona
duken
se te humbja rrugullisen

*Fernando Manes profesor**γέννεσις e φθορά*

tha njetër here dhon Fernandi

lefemi e kem të vdesmi

piksemi e losemi

gjithësej ndrofet ket rreth'i gjelles

u ngë di që duan këta që thufen konservatorë

Çë duan të vlojin

këta që jan tash të ndërruar ka gjaku ka i cili vijin

i ndryshëm gjaku i atit që u nderrua me gjakun e s'jemës

e si thoj ai i madhi

“ket moti i duhur ke të lëshë ketë dhe

ku erdhe e i vodhe frymën atij njeriu

kujit ke t'i paguash dëtyrën pse u leve

Për nga moment e për nga gjë

është shkruajtur

it's time to go

Këtë thot syu ynë njersor

këtë duket se na vërteton syu ynë shpirtëror

Vë re:” kjo ë nj'apori”

thoj dhon Fernandi me thavmasi

Viçënx Mele gjyqtar

“Nani j’arrum
 e sipër neve mosnjeri është më lart
 vet Perëndia”

“U lodhe” – thoj gjyqtari Mele
 çë më qe udhëheqës në Alpet e Rosa-s –
 “lodhësia mund t’jet se është mera
 lodhësia e vërtetjes
 sa të harrohesh
 çë të qellin ket çuka e njëj mali
 ket ti babare pa pasur një pikë
 ket mund vësh fund

Nani heshtu
 gjegjë si hapet e paqme qetsia
 ket këta tremilë e pesqind metra

kur ngë ke që të bësh me mosnjeri

Vet shëjtrat banojin malet
e ishin një herë sarua
ket Shpellazit e Merkurit
e Armupan
drejt si bënej Jisuj
që hiqej i vetëm ndër çukat
kur e mirr nevoja të fjit me t'Jatin

Ti që di e mbafë kocaposhta
vë re të prierësh pikpamien
kush e di mos hereherë
do të humben fjalët e moçëme
që na pengojn
e nëng' j'arrëmi të shohmi shërbise të rea
asedhe ket një çukë mali
te ku të hapet horizonti pa kufir

Annunziato Baldacchino administrator

Mban mend, Nucja', akoma
 kur mbrëmanet e gushtit
 bëjim një stitje ka rrahj'i Farnitës
 ti komunist ateist
 u komunist sipas besës së Vangjellit?

Ishim të marrë të dy ket nj'e lartë shpresë
 ti ëndërnje rivołucjonin marksiste
 u Rregjerin' e qiellit
 ture shërbier të Mirin
 ket reggjëri' e të Ligut
 sa të sillëjim te bota të reat e lirinë
 e cila lumtësinë
 do t'i kish dhën përmon çdonjeriu

Ishim të rinjë ahirna e mund t' jetë
se bisedojim pa ditur mir atë që thojm

Mendon, Nucja', adhe?

Djovasjim “Politeja-n” e Platonit

e “Qitetin e diellit”

e kalavriotit të madhë Campanella

e ëndrrim ata qitetë që nëngë ka llok mbi dhe

e të Marksit të parin libër të Kapitalit

e “De rerum natura” m’e ofronje

për si materialist

pikpamjen të ndërronja mbi Hyjnin

Ti pra ike e tanët bisedime të dhezur

shuajti mot’i lodhët

pse te rrethi i tij nëng ndërrofet gjë

edhe psena nga ndërmarrje njeriu

vete te humbja

Qindrova u, ture parë ato shpresë

të bëna fjalë libresh
ëndre intelletualesh pa fund
çëmenduri kur dukej se u kishin
zdripur ndër dhe si fat i mir i njeriut

Gjellonj akoma ket kjo botë e zezë
te ku kapitalizmi u bë më i keqë
ture dorrokopsur botën

Vrenj popà i pabesëm
eterogjeneitetën i kufivet
çë akoma na mashtrojin

U nani jam si kallm'i Pascal-it
po ngë më ngushullom
se jam kafsha e mirë të mejtonj gjithësejen
Harronj përmjet mejtimet e mia
sa i mjer jam, sa murgulaq
se vete ktej si vete atej skutina
kur i fryn ka deti levandina

Giuseppe Gigliotti mësues

U bën sarua ata libre
ç'ishin një herë vet theatr'i Pirandello-t
e rrëfimet e Verga
këta të part çë ti më ksilove

Adhe më ruajin
ka libraria e qoshme auktoresh
argumentesh më të thellë
prapa të cilvet mund të të biren kryet

e kam edhe ata çë ti mjeshtër na djovasnje
litisht “*Senza famiglia*” e “*Robinson Crusoe*”
per me civilisuar neve arbreshë

I desha tëndët *Robinson e Remigio*

njera kur ishin të bjerr ndër lloke të huaj
si Ulliksi

pra kur i shpëtoj fati e gjetëtin një shpi
më zu një mallinkonië e madhe
sikur t'ju kish mbaruar gjella

Ki është fati të djovasësh edhe
një të biresh ndër mejtimet
pra kur j'arrën një e vërtetë
të lidhin me ferxha të rënda
e s'ke më e udhëtimit lirinë
një mortje të rrëmben

Paskal Pissarro profesor

Ng'ë fare i çuditshëm të të kujtonj
ket kjo Pashkë të rëngjallje
ndersa n'agim bien kumborët më hare

Pse t'ëndra ket kjo haraksi e shëjte?
Mund t'jetë pse sot s'do të gjegjet zëri it
të këndonjë *Χριστός ἀνέστι*

Ishim një herë bashk më të zgjerdhurit të korit
te kathedrallja e Ungris
e nani edhe zëri im u qet

I vemi akoma prapa ksaj sprënxje?

και τοις εν τοις μνημασι ζωνν χαρισαμενος
sa herë e kënduan me vuxhë të shkilqiera

te paravera e gjelles sonë

Kur ndër t'ardhmjet ditë

do të persëritinj të kendonjë

me zënin e heshtur të kujtesit

o αγγελος εβοα

ea e prezë më rri

e bë mos të më marrë ndonj' merëngi

Luigi Le Voci artist

Ngë erdhe kurrë
 të më gjënje ndër ëndret
 ti dishipuli
 e mjeshtri e miku vëllazërori im
 Qem bashk të marrë ka shumë pralla
 e u vure më këmb ture përshkuar botën
 i marr ka ai libër “*On the road*” që të kisha dhuruar

Pra u mbete Paris artist i qellur ka era e fjalëvet
 të Hemingway e ka ëngjëlet e Chagal-it
 e ka i tjetri Ëngjëll që lufton me Japkun
 te klisha e *Saint Sulpice*

Gjikun nëng gjete rrëçet
 asedhe Milan
 asedhe Romë

te ku mbetëtim bashk
ture ngrën e ture pir
përposh diellit e njëj prilli i ngroht

Shprishtim pra bubuqe lulesh
ka terrasi it tue qeshur
pirposh në *via del Pellegrino*
e nëng pandefje se *il destino*
do të të kish marr anangast i keqë

Anton Barletta profesor

Ti më i miri ndër të mirtë më i dashuri
 nder të dashurit, e mik ndër miqët e mi
 vije e me gjeje më shpi
 kur ngjatej nata te ditët e Shëndreut

Jasht madhësofshin llavinat e shiut
 mbrënda ngrëfshin të larta fllakat e zjarrit
 ka kucari i madhë çë digjë ket vatra

Pijim verë
 përshtipjëm qiçëra
 ndersa zënje fill e mësonje filosofi
Esprit de geometrie komentarnje
Esprit de finesse në çarjen e bukës së dijturisë

“Mundët ki i dyti

ndose ket artja jote
do t'i vësh të dy bashk
e kërko - të qëft kjo filozofia.-
atë muzikë e thellë
çë fëshefet ket mbrëndja hyjnore e ngagjë
e lëre vetëhenë tënde kur je krijon
le të madhësomet vepra jote se cilës do t'jesh rop
me një lulëzim i mbrëndshëm pa qëllim

Po gjegj ka bëfet sirenë ki mashtrim ç'ë artja
Po mos i ki turpë të hish ket matj'e motit
e ket matj'e fjalëvet
çë na bëjin të bindur se gjikun vemi”

E më mbolle mbrënda farën e përjashtësisë
çë më singojë si i huaj anamesa të tjervet
si Tonio Kröger ç'i pari më vure ndër duar
e u qella me mua si një tallisman i pandarshëm
.... ..

Ndon Sassone Junior sociolog kerkues CEDE

Çë vejim ture kërkuar Romë
ndose pra qanje gjittonitë e Ungris?
e vejim si ato të famëshe maçe t'esura të Koloseut

Çë kërkujm Romë?
na ç'i mirrjim vesh
zërit çë na thërrit
"lëni shpin e etravet
ket fëshafen hyjnit e rreme"

Kërkujm, mund t'jet, një përfaqim gruaje e huaj
si ato çë si pulbardha ven e vijin e pra prëfen
te arvuret gjat Teverit?

Po gjë e xum

gjithëve t'i përgjegjëshim :“Jo. Sosën. Jo më”

gjithë atyrve

çë do' të të bëjin të bindur se fjal'e tyre ë gjë

Xum se edhe partiti komunist ,

jo më pak i themeluar ket një besë,

ish si të tjerat qishë:

kish rite e dogme çë ngë lefterojin

Xum se kish' të vejim xheshur pa këmish

e xathur

pa ideologji çë, si do t' jet,

të bën fashist i ngardhamost

E i dham një falje njeriut të lashtë

i lidhur me fe, me sprënxa, me be të rreme

pretendimevet e të lashtit Perëndi

i remë si gjithë qishat ç'e adhurojin

Na kish varesur Historia, Filosofia, e Skencia të vjetra
na kishin varesur romanet, gjithë literatura
e prisjim, prisjim të reat dhe gjellen e tjetër

Po çë gjetëtim Romë
çë nëng do të kishim gjetur Ungir?

Ngë kishim ngamon qën
mbrënda një ekuivok
çë biret si shura
kur frin era e njomë
e shirokut ka Taverna?

Ngë ishim edhe na ngaherë
të shirokartur Romë
na çë dijim e përsëritjin fjaalin e rëndë
Λαθε βιοσας?

Kush ish i zgjuar?

Donje të reat

e të hanej veshlat nostalgia e të vjetravet

e të shpisë atërore:

Ungra Ungra Ungra

qëllofshe mbi Ungrin

e mbi kujtimin e të sajavet gra

Ti pra te një tavut Ungir u prore

me zëmërin e pandëndur

Pa oreks të reavet u qindrova

e nëng ndëlgova asedhe

ndose vdeqja ë gjellë

o ndose gjella ë vdeqje

si thoj një i math kujit i mora veshë

sa të shëronja indiferent lakosa

ndersa venja i magjepsur e i hunduar

ka shumë këndime sirenash.

Më qindruan vet këto fjalë të vjetra

çë të ofronjë si ket kujtim'i kujtuar
i çova
ndërsa i huaj
të prëfsha ka dhëmbësit e botës së huaj kërkova

Këto fjalë të moçëme çë rrizikojin,
ndërsa duan të mbahen, të poshtërohen
ose të bëfen karnivall
keto fjalë çë na magjepsjin e na gënjejn
e mundshme e pamundshme ket domethëna e tyre
jan ato çë na sielljin të reat
me gjithë dëshpërimin ç'i vjen prap
ruaji, e mirri vesh, jan totet.

Gjith të tjerët

Muartit barrin e gjelles
si mirrjit ndër krah një barr dru
një thesë me grurë
një vallun me rrushë

më të shumët me lehtësi
pa i dhën kujdes vetëhesë së vetëme
ngë vin' ka ju rrëndësia e saj

Prëfshit ka keqësia ture u hunduar
me një qeshje, me një gazë i papritur
me një këndim, një fest, një pirukë

Sikur ture bën një udhëtim të gjatë
ule i dërsitur mbi një gur
e ha për s'esulli çë do të ndodhet

për të zësh zëmërin
e merr frym
se të përsëritish udhën tënde njëra te dita e ligë
ku udha ka fundim

“Nihil dedit natura humanis sine labore”

vu më vjersh litiri
atë çë gjithë bota di
jo pse na vu mbi sy
ndonjë hjyni e keq
po pse fati ynë ë shndërrim
i cili do shqyerje çë dhëmben
për një ndryshim i math çë nget edhe yllet

ndërruam
ndryshuam botin
(kush do të priret më te lloku juaj)
po mban
qindron dhëmbja
fati i keq i njeriut.

Kush e di ndose prëfeni ju nani
ndose një hare ju mori
drejt si ju mirr ktej
lehtësia e njëj gëzim'i math
të dashurin Xhusep i Nikroçës
e kushiririn tim Teodhorin

I dhezinj këtyre këtë qiri
e bënj e bie kumbor'e kujtimit
αἰωνία ἡ μνήμη
i kotshëm për 'ta
sanënga një ngushullim për ne

SI PASTHËNIE

*Pra si ngrëfen ka mesimvria
lluparat që mbulojin rehjet e Sybarit
e detin Jon
me detin e mjegulavet*

*kështu do të ngrefen retë e harramjes
e do të mbulojin domethënien
e këtire fjalëve të kota*

..... ..

*si biremi,
si biermi motin
po fare gjë ë i dinjë t'jet bën
e na kastjon moti se e lëmi të verë*

pa i dhën vler

*hapin pra moti ka mesimvria
e façofen largu përpajnat e Sila-s*

gjë është që ngë shomi përposh mjergullat e mendjes

ket fshefja gjë fëshefet

*e këta ndjezot ç'u spirirtim,
ç'u ndajtin ka dashuria jon botore
cila llupar ë e fëshefîn*

*nodose llupara jan
gjë jan e fëshefjin
ket gjë zë o gjë mbaron*

*Të dashurit
zut ket zëmëra jonë njetër gjelle
Αίωνια η μνημη
o një e tjetër gjelle
zë jasht ka zëmëra jonë
e pret ka një llogjismë
një dhën ligjë
çë u ngë di e jap
me të cilin u ngë di e bindënjë?*

*s'jam fare i kënaqur
aqë syvet e kurmit
aqë syvet e mendjes
nj'ajër i murrët i fashqon
si një llupare*

Nando ELMO (arbërisht: Nandin'i Helmëravet) u le Firmozë (Acquaformosa, CS, Italy) ket e treta ditë e Shinmirtirit 1938.. Ësht skrimëtar, poet, eseist litisht e arbrisht dhe piktor i njohur. Bëri studimet te Universiteti "La Sapienza" Romë edhe Palerm teku u diplomar në literasi modherne. Te Univesitet'i Torino u ekspertizua në "Gjuhësi e përgjithëshme e Semjologjië". Gjellon e vepron në Rivarolo Canavese te krahina e Torino. Ësht i cituar si i rëndësishëm intelektual arbëresh te libr'i Demetrio-t Emmanuele "Arberia". Një shenim të gjatë dhe të qosmë i dedikon historiku G. Laviola te vepra e tij: "**Dizionario biobibliografico degli Italo-albanesi**."

”